

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehte trupor nga neni 188/3-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore—DP në Gjakovë, PP/II.nr.1161/16 të datës 27.08.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **16.08.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala ,te dëmtuarit A. B. dhe të akuzuarit A. B., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. B.**, i biri A. dhe i nënes H. e gjinisë L., data e lindjes..., Gjakovë, me banim ne Rr..., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, e gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i pa martuar .

#### Ë s h t ë f a j t o r :

##### Sepse:

**-Me dt. 21.07.2016, rreth orës 14.15 min., në rrugën “S.” në Gjakovë**, saktësisht ne banesën e tyre te përbashkët, i shkakton lëndime te lehta trupore te cilat rezultojnë me dëmtim te përkohshëm te shëndetit personit tjetër te dërmuarit babait te tij, A.B. në atë mënyrë qe derisa i dëmtuari në ditën kritike ishte në banesë i pandehuri fillimisht e fyen me fjalë si “budall, psikopat çka po sillesh ne dhomë “dhe në momentin kur i dëmtuari i është përgjigjur se po dal ta ndezi një cigare, i pandehuri duke kundërshtuar çfarë cigare, i revoltuar me duar fillimisht e kapë për gjoksi duke e shtyre përplasur për dollap (orman ) ku si pasoj e dhimbjeve rrezohet ne tokë ,me ç’rast te dëmtarit i shkakton lëndime te lehta trupore të konstatuara dhe përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore te ekspertit mjeko –ligjor Dr. V. K. te dt. 10.03.2017.

**-me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/3-1- te KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188/3-1 te KPRK-ës dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit i shqipton:

### DENIM ME KUSHT

**Dënim me burgim me kohëzgjatje prej 3(tre) muajve ,i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .**

I dëmtuari A. B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej **20,00 €**, si dhe ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1161/16 te dt. 27.03.2017, e ka akuzuar të akuzuarin A. B. nga Gjakova për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3-1 të KPRK-së.

Prokurori shtetit Ramiz Buzhala, ne shqyrtimin fillestar me dt. 16.08.2017 lexojë aktakuzën PP/II.nr. 1161/16 dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari A. B., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se deri te kjo vepër ka ardhur pa dashje me qene se unë nuk e kam goditur por vetëm kam dashur ta largojë dhe vetëm e kam shtyre ,mirëpo për shkak te gjendjes se tij i njëjti është rrezuar me shpin duke e prekur ormanin ne dhomën time te gjumit, premtoj se një veprim i tillë nuk do te përsëritët ,kërkojë falje nga i dëmtuari për lëndime e shkaktuara, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ne çdo fazë te procedurës , gjendjen e varfër ekonomike si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme.

I dëmtuari A. B., në shqyrtimin fillestar , deklaroi se nuk i bashkëngjitët ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari A. B. - me dt. 21.07.2016, rreth orës 14.15 min., në rrugën “S.” në Gjakovë, saktësisht ne banesën e tyre te përbashkët ,i shkakton lëndime te lehta trupore te cilat rezultojnë me dëmtim te përkohshëm te shëndetit personit tjetër te dërmuarit babait te tij, A. B. atë mënyrë qe derisa i dëmtuari në ditën kritike ishte në banesë i, i pandehuri fillimisht e fyen me fjalë si “budall, psikopat çka po sillesh ne dhomë “dhe në momentin kur i dëmtuari i është përgjigjur se po dal ta ndezi një cigare ,i pandehuri duke kundërshtuar çfarë cigare ,i revoltuar me duar fillimisht e kapë për gjoksi duke e shtyre përplasur për dollap (orman ) ku si pasoj e dhimbjeve rrezohet ne tokë ,me ç rast te dëmtarit i shkakton lëndime te lehta trupore të konstatuara dhe përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore te ekspertit mjeko –ligjor Dr. V. K. te dt. 10.03.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte në gjykim, pendimin e tij të shprehur në gjykate, premtimin e ti se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, kërkim falja nga i dëmtuari për lëndimin e shkaktuar, deklarimi i te dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi, gjendja e varfër ekonomike si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, peshën e veprës penale, kështu që me dënimin me burgim ne kohëzgjatje 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet me kusht që i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1( një) viti të mos kryejnë vepër tjetër penale ,do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPK-së,. me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar është në proporcion me vepren penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve te dëmtuara ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mur konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr. 225/17 më datë 18.08.2017.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.